



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele**  
**PA1: 08-84**  
**14.04.2026**

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafët 1 dhe 10<sup>1</sup> të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në pajtim me nenin 54, paragrafi (4) dhe nenit 104, paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-84 datë 26.3.2026 dhe Propozimin PA1 nr.08-84 datë 9.4.2026, në pajtim me Konkluzionin, nr.ark.02-1701/2 datë 9.4.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 14-të mbajtur më 9.4.2026 miratoi:

**AKTVENDIM**  
**për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen**  
**e lejes për transmetim televiziv**

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (ShTR) TELEVIZIJA PLUS ShPK Kumanovë, PA1 nr.08-626 datë 7.9.2023.

**Arsyetim**

Këshilli i Agjencisë për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuele (AShMA) në seancën e 12-të mbajtur më 30.3.2026, me Konkluzion nr.ark.02-1331/4 datë 31.3.2026, miratoi propozimin e dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë, PA1 nr.08-84 datë 26.3.2026 dhe inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TELEVIZIJA PLUS ShPK Kumanovë, PA1 nr.08-626 datë 7.9.2023, për shkak se pas mbikëqyrjes së kryer të rregullt administrative, në Raportin me shkrim nr.ark.05-1326/1 datë 25.3.2026, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga ASHMA, nuk ka përmbushur detyrimin e nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV), përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv ASHMA-së.

Në lidhje me këtë, nga ana e ASHMA-së më 1.4.2026, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur iu dërgua Shkresë PA1 nr.08-84 datë 1.4.2026, për njoftim se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, do të marrë

<sup>1</sup> Nënparagrafët 8 dhe 9 shihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).



**Агенција за аудио и  
аудиовизуелни  
медиумски услуги**

**ул. Македонија бр.38  
1000 Скопје  
Република Северна  
Македонија**

**Тел. + 389 2 3103 400**

**[www.avmu.org.mk](http://www.avmu.org.mk)  
[www.avmu.mk](http://www.avmu.mk)  
[contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)**





**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

---

vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv. Njoftimi më 1.4.2026 është dorëzuar dhe në mënyrë elektronike në e-mail adresën zyrtare të transmetuesit, regjistruar si informacion për kontakt në RQRMV dhe në regjistrin e radiodifuzerëve që udhëhiqet nga Agjencia.

Megjithatë, më 9.4.2026 nga Sektori për financa dhe logjistikë, drejtuar drejtorit të Agjencisë është dorëzuar Njoftim, nr.ark.05-1326/2 datë 9.4.2026, se ShTR TELEVIZIJA PLUS ShPK Kumanovë më 9.4.2026, ka kryer pagesë në shumë prej 281.341,00 (dyqind e tetëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e një) denarë, me të cilën transmetuesi kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv e ka paguar plotësisht.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafët 1 dhe 10 të LShMAAV, në pajtim me nenin 54, paragrafi (4) dhe nenit 104, paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-84 datë 26.3.2026 dhe Propozimin PA1 nr.08-84 datë 9.4.2026, në pajtim me Konkluzionin nr.ark.02-1701/2 datë 9.4.2026, Këshilli i Agjencisë në seancën e 14-të mbajtur më 9.4.2026, vendosi ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
mr. Sasho Stefanovski**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani